



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU  
ADRESA Rruga "Abdyl Frashëri",  
EGT TOWER, Pall 17/6, Kati 2, Ap. 1,  
Tiranë  
TEL: 694041500

## KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)


Nr. repertori: 5266

Nr. koleksioni: 1423

Tirane më 15/08/2023

Ligjet referuese:

- Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë personale", i ndryshuar
- Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2023050620163226678



A2023050620163226678

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI  
(TË SHOQËRISË "DION ENERGI" SHPK)

Sot, më datë 15/08/2023, para meje Notere Ardjana A. Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Abdyl Frashëri", EGT TOWER, Pall 17/6, Kat 2, Ap. 1, Tiranë, u paraqit personalisht:

Z.Shkumbin Qormemeti, atësia Uran, amësia Gzime, shtetas shqiptar, lindur në Dibër, Republika e Maqedonisë së Veriut (MKD) dhe banues në Tiranë, lindur më 09/07/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga Pasaporta ID Nr. BB5705520 dhe Nr. Personal I10709194P.

(këtu e më poshtë referuar si "Shitësi")

Shoqëria "InvestALB & Konsulencë" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M21318038Q, me adresë "Bulevardi Bajram Curri", Kullat Binjake, Kulla Nr. 1, përfaqësuar nga Administratori Z.Ditjon Baboci, atësia Agim, amësia Kozeta, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, lindur më 15/11/1986, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 037404563 dhe Nr. Personal I61115052H.

Z.Artan Sako, atësia Sadik, amësia Meafte, shtetas shqiptar, lindur në Nivicë, Tepelenë dhe banues në Tiranë, lindur më 30/05/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID Nr. 034080337 dhe Nr. Personal H20530054L.

(këtu e më poshtë referuar si "Blerësit")

Zj.Fiona Dizdari, atësia Faik, amësia Genta, shtetase shqiptare, lindur në Republikën Ceke dhe banuese në Tiranë, lindur 25.05.1993, gjendja civile "e martuar", madhere dhe me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova nga Pasaporta Nr. BE4554463 dhe Nr. Personal J35525069A.

(këtu e më poshtë referuar si "Dhënëse e Pëlqimit")

Duke qenë se:

- I. Shitësi, Shkumbin Qormemeti, është Ortak i Vetëm i Shoqërisë "DION Energji" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në QKB sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, me Numër Unik Identifikimi Subjekti (NUIS) L81715030A, me seli Rruga "Bogdani", Pallati nr. 32, Shkalla nr. 1, Apartamenti nr. 51, Tiranë, me kapital të regjistruar prej 100,000 (njëqind mijë) lekë, me numër të përgjithshëm të kuotave 1 (një) (këtu e më poshtë "Shoqëria" ose "DION Energji" SHPK);
- II. Shitësi do t'i shesë Blerësëve, kuotën e zotëruar prej tij në Shoqërinë "DION Energji" SHPK, që përfaqëson 100.00 % të kapitalit të Shoqërisë, dhe Blerësit do të blejnë respektivisht kuotën e zotëruar prej Shitësit që përfaqëson 100.00 % të kapitalit të Shoqërisë;

Palët, në përputhje me nenin 72, 73, 74 të Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenet 6, nenet 84-90, 705-756 të Kodit Civil, nenin 74 i Kodit të Familjes dhe Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve Nr. 5, datë 22.06.2023, të shoqërisë "InvestALB & Konsulencë" SHPK" (bashkëlidhur kësaj Kontrakte) bien dakord sa më poshtë:

Neni 1  
Objekti



A2023050620163226678

- 1.1 Shitësi - Ortaku i vetëm i Shoqërisë "DION Energji" sh.p.k, Shkumbin Qormemeti - zotëruesh i 1 (një) kuote, në masën 100 % të vlerës së kapitalit themeltar të Shoqërisë (këtu e më poshtë "Kuota"), bie dakord t'i shëse Blerësve, Kuotën e zotëruar prej tij bashkë me të gjithë të drejtat dhe titujt që rrjedhin nga shitja e saj në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) Euro (në vijim referuar si "Çmimi"), përkatësisht:
- Shoqërisë "InvestALB & Konsulencë" sh.p.k në masën 50 % të pjesmarrjes në shoqëri, në vlerën 30.000 (tridhjete mijë) Euro.
  - Z. Artan Sako tij në masën 50 % të pjesmarrjes në shoqëri, në vlerën 30.000 (tridhjete mijë) Euro.

- 1.2 Sa më sipër Kuota e Shoqërisë "DION Energji" sh.p.k me nënshkrimin e kësaj Kontrate i kalon përfundimisht Shoqërisë "InvestALB & Konsulencë" sh.p.k në masën 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë dhe Z. Artan Sako në masën 50 % të kapitalit themeltar të Shoqërisë, të cilët të dy së bashku do të përfaqësojnë 100 % të pjesëmarrjes së kapitalit themeltar të Shoqërisë.

**Neni 2**  
**Cmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës**

2.1 Palët bien dakord se Çmimi, sipas përcaktimeve në nenin 1 më sipër do të paguhet nga Blerësit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët.

2.2 Llogaria bankare e Shitësit ku do të bëhen pagesa e Çmimit e parashikuar në këtë Kontratë është si më poshtë:

Emri: Shkumbin Uran Qormemeti  
Banka: CREDINS BANK sh.a., Rruga 'VASO PASHA', Nr.8, Tirane  
Kodi SWIFT: CDISALTRXXX  
Numri i Llogarisë Bankare: 00001801724 në EUR  
IBAN: AL71 2121 1009 0000 0000 0180 1724

**Neni 3**  
**Transferimi i pjesëmarrjes në Kuotë**

3.1 Të drejtat e pronësisë së Shitësit mbi Kuotën e zotëruar në Shoqërinë "DION Energji" sh.p.k, do t'i transferohen Blerësve menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.

3.2 Transferimi do të ndodhë menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate, duke MOS u kushtëzuar nga regjistrimi i saj, i cili do të ketë efekt deklarativ.

**Neni 4**  
**Përfaqësime dhe garanci**

4.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi përfaqëson dhe i garanton Blerësit se:

i. Shitësi është zotëruesh i ligjshëm i Kuotës në Shoqërinë "DION Energji" sh.p.k, e cila përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtat e pronësisë mbi Kuotën, të tashme apo potenciale dhe Kuota është tërësisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë siguruese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.

ii. Shitësi deklaron se nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj Shoqërisë dhe Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të pashlyer ndaj Shitësit apo palëve të treta dhe nuk ka pretendime nga ndonjë palë e tretë mbi të drejtën e tij mbi shoqërinë të tashme apo potenciale, e cila mund të ketë një impakt financiar në të ardhmen. Në rast se Palët vijnë në dijeni të ndonjë detyrimi që duhet taë ishte shlyer përparrë nënshkrimit të kësaj Kontrate, ose duhet ta shlyej Shitësi, ai deklaron se e njeh atë detyrim dhe merr përsipër shlyerjen e sajtij.

4.2 Secila prej Palëve kontraktore garanton se, përbush kushtet ligjore të nënshkruajë këtë Kontratë dhe të gjitha kushtet dhe afatet të kësaj Kontrate janë të detyrueshme për t'u zbatuar prej tyre.

Fq. 2



A2023050620163226678

Neni 5  
Taksat e aplikueshme

5.1 Të gjitha taksat, tarifat dhe detyrimet e një natyre tjeter, të tashme dhe/ose të mëvonshme në lidhje me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të paguhën sipas ligjit.

Neni 6  
Të ndryshme

6.1 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë midis palëve në lidhje me objektin e kësaj marrëveshjeje dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimet e mëparshme, në formë të shkruar dhe verbale, midis palëve nënshkruese. Nuk ka deklarim, premtim, deklaratë ose qëllim në formë të shkruar ose verbale, midis Palëve që nuk është përfshirë në këtë Kontratë që mund të kënë pasojë ose efekt mbi Kontratën ose objektin e saj.

6.2 Kjo Kontratë nuk do të ndryshohet, zëvendësohet ose anulohet përveç se me një dokument në formë shkresore të nënshkruar nga të dyja Palët dhe çdo dokument që ka për qëllim të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojë Kontratën ose pjesë të saj nuk do të jetë i detyrueshëm dhe nuk do të ketë efekt deri në momentin që nënshkruhet dhe dorëzohet nga të gjitha Palët.

6.3 Nëse ndonjë nga nenet e Kontratës shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e neneve të tjera nuk do të ndikohet. Neni i pavlefshëm do të zëvendësohet nga një i vlefshëm i cili i korrespondon sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të palëve.

6.4 Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe fjalët në njëjës do të përfshijnë edhe fjalët në shumës dhe e anasjlltas, fjalët që përfaqësojnë një gjini do të përfshijnë edhe gjininë tjeter. Gjuha e kësaj Kontrate në të gjitha rastet do të interpretohet si një e tërë në përputhje me kuptimin e saj të drejtë dhe pa nënkuqtar supozime se kushtet në të duhet të interpretohet më rreptësisht kundër njërisë Palë; bëhet me dije se të dyja Palët kanë marrë pjesë në hartimin dhe negocimin e kësaj Kontrate.

6.5 Kjo Kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.6 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskuluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6.7 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në adresat përkatëse të Shitësit dhe të Blerësve, nëpërmjet letrës rekomande me kthim përgjigje ose postës elektronike. Çdo njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse verifikohen kushtet vijuese: (a) nëse është dërguar me postë elektronike, në momentin në të cilin është marrë posta elektronike; (b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

Dispozita përfundimtare

Kontrata hartohet në 6 (gjashtë) kopje originale, në gjuhën shqipe. Të gjitha Palët e lexuan atë dhe deklarojnë se Kontrata është konformë vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar dhe në shenjë pranimi e nënshkruajnë atë.

Kontrata, u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njoën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e Palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përbajtjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.



A2023050620163226678

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



PALËT NË KONTRATË

PALA SHITËSE:

Z. SHKUMBIN QORMEMETI

*SHKUMBIN  
QORMEMETI*

Dhënës i pëlgimit

Znj. FIONA DIZDARI

*F.D.*

*FIONA  
DIZDARI*

PALA BLERËSE:

"INVESTALB & KONSULENCË" sh.p.k

Përfaqësuar nga:

Z. DITJON BABOQI

*DITJON BABOQI*



Z. ARTAN SAKO

*Artan Sako*

*NOTERE*  
Ardjana A.Mediu

*[Large blue ink signature over the note]*

## REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit te kerkimit: D-20230815171026452  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 15.08.2023  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 17:10:26  
**Lloji i Kerkimit:** Emri i Personit Fizik  
Numri i Dokumentit: D-400-005-918

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

### SHKUMBIN URAN QORMEMETI

Fundi i Rezultatit te Kerkimit


Fundi i Dokumentit





Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator  
Selvia, Kati XII  
TIRANE, SHQIPERI  
TEL/FAX.:355 4 2420005  
TEL:355 4 2420006  
Email: rbs@roen.al.com



## REZULTATET E KERKIMIT

Numri i Rezultatit te kerkimit: D-20230815171026452  
Data e Rezultatit te Kerkimit: 15.08.2023  
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 17:10:26  
Lloji i Kerkimit: Emri i Personit Juridik  
Numri i Dokumentit: D-400-005-918

### LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0

DION ENERGJI SH.P.K.

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit



### SUBJEKTI KERKUES:

Emertimi  
ARDJANA ALI MEDIU P.F.

### TE DHENAT E PERDORUESIT:

Emri dhe Mbiemri  
ADMINISTRATORI



**EKSTRAKTI REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L81715030A
2. Data e Regjistrimit	15/05/2018
3. Emri i Subjektit	DION Energji
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	15/05/2018
6. Kohëzgjatja	Nga: 15/05/2018
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Bogdani, pallati 32, shkalla 1, apartamenti 51, Njesia Administrative 5
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	<p>Shoqeria ka per objekt kryerjen dhe marrjen pjese ne te gjitha aktivitetet qe nje shoqeri me perjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjisacionit shqiptar, dhe ne vecanti: Aktivitet ekonomik ne energji, import eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te energjise elektrike, mallrave, certifikatave te gjelbera dhe gazit; ndermjetesim ne fushen e tregtise se mallrave dhe ndermjetesim ne lidhjen e kontratave mes kompanive private, dhe mes kompanive private dhe institucioneve shteterore. Projekte dhe punime inxhinierike, studime te ndryshme profesionale qe mbulojne fusha te punimeve civile dhe te punimeve ne fushen e energjise. Zhvillimin dhe realizimin e ndertesave, rrugeve, urave, autostradave, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, linjave nentokesore e mbitokesore per energjine dhe telekomunikacionin, centralet dhe hidrocentralet, nestacioneve transformuese, instalimin e paisjeve elektrike dhe te sistemeve te matjes, te sistemeve SCADA, objekte turistike, rrjetete inxhinierike, objekteve industriale realizimin e studimeve urbane, kryerjen e te gjitha restaurimeve. Kryerjen e projekteve ne funksion te marrjes se' lejeve te ndertimit/zhvillimit; kontraktimin e shoqerive te projektimit/ndertimit dhe shtiblerje., Zhvillimin, realizimin, operimin dhe mbirimbajtjen e veprave energjitike ku futen dhe centralet e prodhimit te energjise nga burimet konvencionale dhe te rinovueshme. energjia djellore.</p>



energjia e eres, energjia nga burimet hidrike. Ofrimin e asistences teknike per realizimin e projekteve te cilat perfshijne punime per zhvillimin e ndertesave, rrugeve, urave, autostradave, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, linjave nentokesore e mbitokesore per energjine dhe telekomunikacionin. centralet dhe hidrocentralet, burimeve konvencionale dhe ato te rinovueshme te energjise perfshire energjine djellore, energjine e eres dhe hidrike, nestacioneve transformuese, instalimin e paisjeve elektrike dhe e sistemeve te matjes, sistemeve SCADA, objekte turistike, rrjeteteve inxhinierike, objekteve industriale realizimin e studimeve urbane, kryerjen e të gjitha restaurimeve. Ofrimin e asistences teknike me qellim te marries se lejeve te ndertimit/zhvillimit; kontraktimin e shoqerive te projektimit/ndertimit dhe shtiblerje. Ofrimin e asistences teknike per perkthimin e dokumentacioneve tekike. Realizimin e projekteve koncesionare dhe/ose partneritet publik privat me institucione te pushtetit qendror dhe autoriteteteve te vetqeverisjes vendore, ne fusha te sherbimit te transportit, menaxhimit te hapesirave publike dhe reklamave, projekteve te mbetjeve te ngurta, menaxhim projektesh ne sektorin turistik dhe ne cdo fushe tjeter ku institucionet perkatese kane kompetencia; asistence shoqerive tregtare dhe/ose institucioneve publike ne kryerjen e procedurave koncesionare dhe/ose partneritetete publike/private. Ofrimin e sherbimeve te ndermjetesimit te marreveshjeve mes shoqerive tregtare (shqiptare dhe te huaja), ndermjetesimin e shoqerive tregtare ne marredheniet kontraktore mes tyre; asistence ne marredhenie me institucione financiare private dhe shteterore. Pjesemarrje me kuota/aksione ne shoqeri tregtare, kryerja e investimeve ne shoqeri shqiptare dhe te huaja, menaxhimi dhe drejtimi i shoqerive dhe asistencia ne veprimtarine e tyre. Kryerja e cdo aktiviteti te lejuar nga legjislacioni per shoqerite tregtare. Shoqeria, me vendim te Asamblese mund te realizoje drejtperdrejte apo ne menyre te terthorte cdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqiptare apo te huaja.

10. Administratori/ët 10.1 Afati i emëritimit	Spartak Isakaj	
	Nga: 15/05/2023	Deri: 15/05/2028
11. Procedura e emëritimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit	ShkumbinQormemeti	
	Para: 100.000,00	Natyre:

12.2 Numri i pjesëve	1,00
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: DION Energji E-Mail: aisakaj@yahoo.com Telefon: 0698080002
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 15/08/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

**VENDIM**  
Nr. 05 Datë 22.06.2023  
**I ASAMBLESË SË ORTAKËVE**  
**TË SHOQËRISË**  
**"INVESTALB & KONSULENCË" SHPK**

Sot, më datë 22.06.2023, Asambleja e Ortakëve të "InvestALB & Konsulencë" SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në QKB sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, me Numër Unik Identifikimi Subjekti (NUIS) M02228023Q, dhe seli "Bulevardi Bajram Curri", kullat Binjake, kulla nr. 1, perballe Kuvendit, katë 14, apt. 49, Tiranë, bazuar në Statutin e shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, zhvilloi mbledhjen në zyrën e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, në Tiranë.

Të pranishëm në mbledhjen e thirrur nga **Administratori Ditjon Baboçi**, ishin ortakët që përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë, si më poshtë:

- **Zj. Amantia Xhafaj**, e bija e Fatmir, e lindur në Tiranë më 31.03.1990, e identifikuar me Nr. Personal J05331058G, zotëruese e një 1 kuote me vlerë 50 % të kapitalit të shoqërisë.
- **Z. Ditjon Baboçi**, i biri i Agim, i lindur në Tiranë më 15.11.1986, i identifikuar me Nr. Personal I61115052H, zotëruesi i 1 kuote me vlerë 50 % të kapitalit të shoqërisë.

**Rendi i ditës:**

- Shqyrtimi i mundësisë për blerjen, nga ana e shoqërisë "INVESTALB & KONSULENCË" SHPK, e një pjese të Kuotës që Z. Shkumbin Qormemeti zotëron si Ortak i Vetëm pranë Shoqërisë "DION Energji" SHPK, e identifikuar me NUIS L81715030A.
- Shqyrtimi i mundësisë për përcaktimin e vlerës së Kontratës midis palëve, për blerjen e një pjese të Kuotës që përfaqëson përkatësisht 50 % të pjesmarrjes në Kapitalin Themeltar të Shoqërinë "DION Energji" SHPK, në shumën prej 30.000 (tridhjete mijë) Euro.
- Autorizimi i përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë, Z. Ditjon Baboçi për kryerjen e te gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.

Ortaket duke pasur parasysh aktivitetin e shoqërisë dhe duke evidentuar ecurinë e saj aktuale dhe në të ardhmen, mbështetur në Statutin e shoqërisë "INVESTALB & KONSULENCË" SHPK dhe në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pas shqyrtimit të çdo pike të rendit të ditës:

**VENDOSEN:**

- Të miratojne vendimin për blerjen nga ana e shoqërisë “INVESTALB & KONSULENCË” SHPK e një pjese te Kuotës që Z. Shkumbin Qormemeti zotëron si Ortak i Vetëm pranë Shoqërisë “DION Energji” SHPK, e identifikuar me NUIS L81715030A, përkatësisht në masën 50 % të pjesmarries në Kapitalin Themeltar të Shoqërinë “DION Energji” SHPK.
- Të miratojne vendimin për përcaktimin e vlerës së Kontratës midis palëve për blerjen e një pjese te kuotës, që përfaqëson përkatësisht 50 % të pjesmarries në Kapitalin Themeltar të Shoqërinë “DION Energji” SHPK, në shumën prej 30.000 (tridhjete mijë) Euro.
- Të autorizojne përsaqësuesin ligor të Shoqërisë, Z. Ditjon Baboçi për kryerjen e të gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.

*Meqënëse nuk kishte më probleme për të diskutuar, mbledhja u deklarua e myllur.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të Ortakëve dhe pas regjistrimit në librin e vendimeve të mbajtur për shoqërinë.*

**SHOQËRIA “INVESTALB & KONSULENCË” SHPK**

**ORTAKËT**

**AMANTIA XHAFAJ**

*Amantia Xhafa*  
*Xhafa*



**DITJON BABOÇI**

*Ditjon Baboci*  
*Baboçi*



**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E  
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	M21318038Q
2. Data e Regjistrimit	18/01/2022
3. Emri i Subjektit	InvestALB & Konsulencë
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	14/01/2022
6. Kohëzgjatja	Nga: 14/01/2022
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE "Bulevardi Bajram Curri", kullat Binjake, kulla nr. 1, perballe Kuvendit, kat 14, apt. 49.
8. Kapitali	200.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Dizenjim software. Analize, projektim i arkitekturës se një sistemi software. Zhvillim dhe mirembajtje sistemeve software. Programimi i sistemeve software, kodimi, instalimi, integrimi i te gjithe komponenteve, dokumentimi, identifikimi dhe korrigimi i gabimeve, modifikime dhe mirembajtja e te gjithe komponenteve, suporti i sistemit. Testim software. Testim i funksionalitetave, ngarkesë ne pune, performances, disponueshmerise dhe sigurisë se sistemit software. Dizenjim dhe zhvillim sistemeve komunikimi. Analize planifikim, projektim, zbatim, vendosje ne pune dhe mirembajtje e sistemeve te komunikimit te rrjeteve te pajisjeve informatike. Dizenjim dhe zhvillim sistemeve te sigurise. Analiza e kërkesave te sigurisë se klientit, projektimi i arkitekturës, instalimet dhe konfigurimet e komponenteve, vendosja ne pune, testimet e sigurisë dhe mirembajtja. Zhvillim sistemeve migrimi. Transferimi i te dheneve dhe infrastruktura te perkatese nga një teknologji e vjetër ne një teknologji të re. Permbysim/upgrade sistemeve informatike. Operimi, manaxhimi, suporti i perdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik per sistemet software. • Studio Projektimi, Mbikqyrje dhe Kolaudimi si dhe ofrimi i shërbimeve dhe konsulencave profesionale lidhur me fushat perkatese. Projekte dhe zbatime te ndertimeve civile, industriale, turistike, bujqesore. Projekte dhe zbatime interieresh.



**QKB**  
Qendra Bashkore e Biçazit  
National Statistics Center

Kopje	<p>Studime, planifikime, vleresime, projekte dhe zbatime urbanistike. Projekte dhe zbatime peisazhi dhe sistemimi. Studime, projekte dhe zbatime produktesh. Studime, projekte, dizenjime dhe zbatime per market. Studime, projekte dhe zbatime te inxhinierise se ndertimit, inxhinierise elektrike dhe inxhinierise hidromekanike. Projekte konstruktive dhe supervizim punimesh. Studime e projekteve dhe zbatime hidrogeologjike dhe gjeologjike. Projektim dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik. Studime fizibiliteti. Projekte dhe zbatime rrugesh, urash, porte turistike. Projekte dhe zbatime linjash dhe sistemesh se prodhimit dhe shperndajes se energjise elektrike. Projektim ujesjelles, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditese, diga, etj. Restaurime dhe konsulenca per sherbimet e mesiperme. • Ndertim objektesh te permasave te ndryshme, shtepi, vita, ndertesa shumekateshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje, sherbim fasade. Ndertim rrugesh dhe urash si dhe ndertime portuale, detare dhe ajrore si dhe rikonstrukcionin e tyre. Asfaltim dhe veshje me asfaltim. Ndertim digash, galeri, tunele, damba. Ndertim vepra kullimi, ujitje, impiante vaditese, punime mbrojtje dhe sisteme hidraulike, punime dhe sisteme elektrike. Import-Eksport te artikujve te ndryshem. • Tregetim mallrash brenda dhe jashte vendit. Per te realizuar objektin dhe qellimin e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje cdo lloj aktiviteti tjeter te lejuar nga ligji vetem ose ne bashkepunim me pale te treta, nepermjet nenkontraktimit, qofte ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promocional, etj qe e vlereson te dobishme. • Analize pasqyrash financiare, keshillimi biznesi me synim permiresimin e performances se sistemeve kontabel, ndertimin e planit te llogarive kontabel, hartim i rregullave te brendshme te shoqerive tregtare, trajnime kontabel, due-diligence financiare dhe operacionale, vleresime te biznesit, kerkime dhe analiza te tregut, keshilla ne qeverisje dhe menaxhime te riskut. • Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme, vleresimin e pasurive te paluajtshme, sherbim ndermjetesimi ne shitjen e pasurive te paluajtshme si dhe cdo lloj pasurie, sherbim ndermjetesimi ne dhenie dhe marrje me qira te pasurive te paluajtshme, keshillime per menaxhim biznesi, sherbim ndermjetesimi per shitje biznesi, si dhe cdo sherbim tjeter ne lidhje me tregun imobiliar ne te gjithe nivelet e sherbimit. • Shoqeria mund te kryej cfaredo veprimtarie tjeter qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi i Republikes se Shqiperise.</p>
10. Administratori/ët	Ditjon Baboçi

10.1 Afati i emërit	Nga: 14/01/2022	Deri: 14/01/2027
11. Procedura e emëritit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	DitjonBaboçi	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
13. Ortakët	AmantiaXhafaj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 100.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: InvestALB & Konsulencë E-Mail: dbaboci@gmail.com Telefon: 0697361473	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 15/08/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Nr. Licencës 16, Datë 31.03.2003; NIPT K316088010  
Rr "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë - Shqipëri  
Tel: +355 4 5353000

Veprimi kaloi sipas urdhërit tuaj

26 TIRANE, 21/08/2023-10:

I NDERUAR Z.  
SAKO ARTAN  
SADIK  
RR R PETRELA P PRANE ARKIVIT  
TIRANE TR

REF: 23001230573/CF1916TR 000224830314

JR 210823 10

Llogaria e urdhëruesit	C01 00001157485 EUR	30.000,00
Llogaria e përfituesit	C01 00001801724 EUR	30.000,00
Përfituesi:	QORMEMETI SHKUMBIN	

Vlera e veprimit	EUR	30.000,00
Përshkrimi:		
KALIM SIPAS KONTRATE NR REP 5266	NR KOL 1423	
DT 15.08.2023		

A. T. a n S o l

CREDINS bank  
Dega Tirana 12  
21.08.2023  
Këshillues Klienti 02

Shënim: Banka nuk mban përgjegjësi për instrukSIONE të gabuara të urdhëruesit

VULA DHE NËNSHKRIMET E CREDI



Nr. Licensës 16, Datë 31.03.2003; NIPT KJ16088010  
Rr."Vito Pasha" Nr. 8, Tiranë - Shqipëri  
Tel: +355 4 5353000

Veprimi kaloi sipas urdhërit tuaj

19 TIRANE, 18/08/2023-11

I/E NDERUAR  
INVESTALB & KONSULENCE SH.P.K


Bulevardi Bajram Curri kullat  
TIRANE TR

REF: 23001223095/CF2006TR 000224736965

TB 180823 11

Llogaria e urdhëruesit C01 00001916828 EUR	30.000,00
Llogaria e përfituesit C01 00001801724 EUR	30.000,00
Përfituesi: QORMEMETI SHKUMBIN	

Vlera e veprimit	EUR	30.000,00
Përshkrimi:		
KALIM SIPAS KONTRATES SE SHITJES NR REP 5266 NR KOL 1423		



Shënim: Banka nuk mban përgjegjësi për instrukSIONE të gabuara të urdhëruesit

VULU DHE NËNSHKRIMET E CREDINS BANK